

PRISHTINA



Komuna e Prishtinës

Opština Priština

Municipality of Prishtina

FTESE

26 Janar 2018

Salla e Kuvendit Komunal, objekti i vjetër i komunës

Ftohen **PRONARËT E BANESAVE KOLEKTIVE (ndërtesave të banimit në bashkëpronësi)** të marrin pjesë në takimin e përbashkët me ç'rast do të prezantohet projekti "*Krijimi i Shoqatave të Pronarëve (SHP-ve) të Ndërtesave të banimit në bashkëpronësi*". Ky projekt është i financuar nga Banka Botërore përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE) dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me komunën e Prishtinës.

Në kuadër të këtij projekti, komuna e Prishtinës është zotuar për të ndërmarrë hapa proaktivë në inkurajimin e formimit të Shoqatave të pronarëve në mënyrë që ato të mund të angazhohen për të ndërmarrë masat për Eficiencë të Energjisë në ndërtesat e tyre me qëllim përmirësimin e komoditetit dhe kursimit të energjisë.

Përmes shprehjes së interesit tanimë të hapur, projekti parasheh përzgjedhjen e maksimum tri ndërtesave kolektive në komunën e Prishtinës, të cilat do të përfitojnë:

- Asistencë në krijimin e Shoqatave të pronarëve dhe regjistrimin e tyre;
- Auditimin e detajuar të energjisë në ndërtesë që është parakusht për hartimin e projektit kryesor për renovimin e ndërtesave me theks të veçantë zbatimin e masave për kursim të energjisë: izolimi i fasadës, kulmit, dyshemesë, ndërrimi i dritareve dhe derës së hyrjes, instalimi ose përmirësimi i ngrohjes qendrore dhe të ngjashme. Auditimi do të ndihmojë të përcaktojë investimet më të dobishme në mënyrë që të reduktojë kostot e energjisë duke ruajtur ose rritur nivelin e komoditetit në banesa;
- Projektin kryesor me paramasë dhe paralogari dhe planin financiar me koston e investimeve të nevojshme për zbatimin e masave të Eficiencës së Energjisë dhe identifikimin e mundësive të sigurimit të fondeve për këtë qëllim;
- Përgatitjen e dokumentacionit për tenderim për masat që duhet të zbatohen si dhe përgatitjen e dokumentacionit për negociim të kontratës me punëkryesin.

Për informimin më të mirë ftoheni të merrni pjesë në takimin informues që do të mbahet me datën **26 Janar 2018, prej orës 10:00-11:30, në sallën e Kuvendit Komunal, objekti i vjetër i komunës së Prishtinës.**

Shpresojmë në interesimin tuaj për t'ju përgjigjur pozitivisht ftesës për pjesëmarrje në takim.